



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primjercë Më/Dana 01.07.2024 vlgod			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shticë Prilög	Vlera Vredmoe
01	110	05	919



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, neni 40.2 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-49, i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr.05/L-108 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-260 - mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (Në pajtim me Ligjin Nr.03/L-048 LMFPP), neni 9, te ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, pika 7, të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2023 dhe të regjistruara në SIMFK, që kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1 për vitin 2023, neni 36, paragrafi 36.2 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 28.06.2024 miraton këtë:

V E N D I M

për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2023 në vitin 2024

Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për bartjen e Buxhetit Komunal nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit 2023 në vitin 2024. Duke u bazuar në Ligjin Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-048 LMFPP), neni 9, te ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, pika 7, të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2023 dhe të regjistruara në SIMFK që kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1 për vitin 2023 barten në vitin 2024 me vendim të Kuvendit Komunal në vlerë prej 321,272.43 € të vitit 2023 në vitin 2024.

Bartja, rritja e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake komunale shpërndahen në këto kategori ekonomike:

- | | |
|--|--------------|
| 1. Mallëra e shërbime në shumë prej | 310,000.00 € |
| 2. Subvencione e transfere në shumë prej | 7,572.43 € |
| 3. Investime kapitale në shumë prej | 3.700.00 € |

Të shpërndara në këto nënprograme buxhetore:

Në kategorinë ekonomike, mallëra dhe shërbime shuma prej 310,000.00 €, në nënprogramet:

- | | |
|--|--------------|
| - Infrastruktura publike (18193) në shumë prej | 170,000.00 € |
| - Shërbimet e shëndetësisë primare (74950) në shumë prej | 80,000.00 € |
| - Arsimi fillor (93960) në shumë prej | 30,000.00 € |
| - Arsimi i mesëm (95160) në shumë prej | 30,000.00 € |

Në kategorinë ekonomike, Subvencione dhe transfere, shuma prej 7,572.43 €, në nënprogramin:

- Zyra e Kryetarit (16033) në shumë prej 7,572.43 €.

Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale shuma prej 3.700.00 €, në nënprogramin:

- Buxhetimi (17533), shuma prej 3.700.00 € në projektin:
- Blerja e fotoapararit digjital professional, projekt i ri në shumë prej 3,700.00 €

Bartja e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024 në kategoritë ekonomike

Komuna: VITI - 657					
Nën/Programi	Kodi i nën-programit	Kodi Funkcional	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	BARTJA 2023
Infrastruktura Publike	18193	0451	22	13	170.000.00
Shërbimet e shëndetësis primare	74950	0721	22	13	80.000.00
Arsimi fillor	93960	0912	22	13	30.000.00
Arsimi i mesëm	95160	0922	22	13	30.000.00
Mallra e shërbime					310.000.00
Zyra e Kryetarit	16033	0111	22	20	7.572.43
Subvencione & Transfere					7.572.43
Buxheti	17533	0112	22	30	3.700.00
Investimet Kapitale					3.700.00
TOTAL					321,272.43

Bartja e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024 nga kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale

Komuna: Viti - 657								
Programi	Kodi i nën-programit	Kodi Funkcional	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Nën kategorit ekonomike (zërat)	Kodi i projektit	PROJEKTET KAPITALE	BARTJA 2023
Buxhet dhe financa								
Buxheti	17533	0112	22	30		Project i ri	Blerja e fotoaparitit digjital profesional	3700.00
TOTAL KAPITALE :								3,700.00
TOTAL:								321,272.43

Arsvetim: Komuna ka tejkalluar planin e të hyrave vetanake të vitit 2023 në vlerë prej 321,272.43 €. Në vlerë prej 310,000.00 € janë rritur mallrat e shërbimet; në vlerë prej 7,572.43 € janë rritur subvencionet dhe transferet, ndërsa pjesa tjetër në vlerë prej 3,700.00 € janë rritur shpenzime kapitale.

Bartja e të hyrave në vlerë 310,000.00 € në mallra dhe shërbime bëhet për arsye të pageses së obligimeve ndaj operatorëve ekonomik në sektorin e shërbimeve publike dhe në sektorin e shëndetësisë bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve, subvencione dhe transfere në vlerë 7,572.43 € bëhet për pagesën e bursave të studentëve dhe pagesën e mjeteve përmes thirrjeve publike, ndërsa bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve kapitale në vlerë prej 3,700.00 në projektin “Blerja e fotoaparitit digjital profesional” project i ri.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
2. Zyrës së Kryetarit;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi

